



**BASHKIA MIRDITË  
POLICIA BASHKIAKE**

Nr. 74 Prot.

Rrëshen më, 08.01.2025

**Lënda: Njoftim për hyrjen në sistemin E-Gjoba të Policisë Bashkiake Mirditë.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore të ndryshuar, ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" të ndryshuar, ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake" ligjit nr. 8378 datë.22/07/1998, "Kodi rrugor i RSH-së i ndryshuar, ligjit nr.44/2015 " Kodit të Procedurave Administrative i RSH-së, ligjit nr. 9920 datë.19/05/2008 " Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, ligjit nr. 9887 datë.10/03/2008 " Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Mirditë me nr. 3884/1 prot datë.19/10/2023.

**Njoftojmë:**

**Të gjithë qytetarët se duke filluar nga data 12.01.2025, Policia Bashkiake Mirditë do të ketë akses si dhe do të nisë aplikimin e gjobave të unifikuara me sistemin E-Gjoba të Policisë së Shtetit, për shkelje administrative, që përfshijnë:**

- 1- Shkeljet e Rregullave të Qarkullimit Rrugor.
- 2- Shkeljet të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
- 3- Dëmtime dhe ndërhyrje në hapësirat e gjelbërta dhe ato publike
- 4- Mospajisje me leje për tregtim apo shërbim jashtë sipërfaqes së njësive, për kryerjen e aktivitetit tregtar pa licencë, autorizim apo leje të tjera të ngjashme.
- 5- Ndëhyrje dhe dëmtime në rrjetin elektrik rrugor.
- 6- Dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza
- 7- Dëmtime dhe vjedhje të grumbulluesve të mbeturinave
- 8- Hedhje të materialeve inerte në vende të pamiratuara.
- 9- Zhurmat dhe Ndotjen Akustike.
- 10- Shkeljet e Rregullave të Transportit Publik.
- 11- Shkeljet në Organizimin e Eventeve dhe Tubimeve.

Ftojme të gjithë qytetarët të bashkëpunojnë dhe të respektojnë rregullat dhe ligjet në fuqi, për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e një komuniteti të sigurt e të rregullt.  
Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

**KRYETARI**  
**Albert MELYSHI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al